



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM**

AN160820230007

Tiranë, më: 12.09.2023

Komisioni 97

**DEKLARATE MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

**Lëshimin e Deklaratës Mjedisore negative, për Zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:**

**Personi juridik:** “MANFI” Sh.p.k.  
**Nr. NIPT-i:** L08114701M  
**Adresa e selisë:** Rruga Nacionale “Koplik-Bajzë”, 500 m larg pulari Elvis, Koplik.  
**Personi përgjegjës:** Redi Berberi

Për të zhvilluar projektin “**Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0.5 hektarë, ose për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektarë**”.

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Objekti minerar “Korthpulë”, Zona Minerare nr 713/5 (Ish Leja Minerare Nr.1481) Pukë, Qarku Shkodër.

**Të dhëna teknike:**  
Sipërfaqe (sipas lejes): 0.047 km<sup>2</sup>

*(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr.10440, date 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit ne mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

*Refuzimi i kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse*

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr.10440, datë: 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshte po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:**

*Drejtoritë teknike të ministries shprehin mendimin si më poshtë vijon: Sugjerohet që gjatë ndërtimit të veprimtarisë, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve si më poshtë:*

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014, "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim";
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve".
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", të ndryshuar;
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme", të ndryshuar;
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar;
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";
- Për të gjiitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035", duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve. Në Raportin e VNM i referoheni VKM nr.175, date 19.1.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve, i cili është shfuqizuar.

o Sektori i mbrojtjes së natyrës sugjeron që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve:

- Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit" i ndryshuar;
- Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër" i ndryshuar, si dhe të bëhet rehabilitimi i zonës me mbjellje pemësh.

o Sektori i pyjeve vlerësojnë se në çdo rast duhet pasur parasysh zbatimin me rigorizitetin e ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 "Për pyjet" në mënyrë të veçantë neni 12, i tij dhe ligjin nr.9693 datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor".

o Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë";

- Të spërkaten rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

o Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit. Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve etj., të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:* Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku kërkon të zhvillohet aktiviteti: “Projekti i shfrytëzimit të objektit të Kaolinës “Korthpulë”, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër, me zhvillues dhe aplikues “MANFI”, me Nr. Aplikimi AN160820230007, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

*Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shprehet se:* Në vijim të aplikimit me Nr. AN160820230007, të depozituar në sistemin elektronik të lejeve për të cilin keni kërkuar mendim për VNM-në e thelluar për Deklaratë Mjedisore, me Subjekt Zhvillues “Manfi” sh.p.k., ju bëjmë me dije se kjo shoqëri është shpallur fitues për procedurën konkurruese për zonën minerare Nr. 713/5, për objektin Korthpulë, Koplik, Qarku Shkodër, njoftuar me shkresën e MIE “Njoftim Fituesi”, me Nr. 3402/2 prot, datë 01.06.2023. Përsa më sipër, MIE, referuar fushës së përgjegjësisë dhe veprimtarisë, shprehet parimisht dakord.

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

Takimi u zhvillua në datë 09.08.2023, ora 11<sup>00</sup>. Prezantimi i projektit u bë nga Z. Enea Dusha i cili ishte i pajisur me një autorizim nga Studio Mjedisore e QMM-së, dhe nuk është i pajisur me Çertifikatë Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis dhe Auditim Mjedisor, sipas Ligjit Nr.10220, datë 07.07.2011, Neni 24. Gjatë prezantimit paraqiti të gjithë efektet e ndikimit në mjedis, masat për minimizimin e tyre (nëse ka), masat për kompensirnin e ndonjë demi të mundshëm që ndodh gjatë funksionimit të aktivitetit. Nga banorët pjesërnarrës nuk pati kontestime apo mendime kundra.

## **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:**

**1. Raporti i thelluar nuk është nënshkruar nga grup ekspertësh të pajisur me Çertifikatë VNM dhe Auditimi Mjedisor,** në zbatim të ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, *KREU VII, Neni 24, Pika 4.2. Raporti i thelluar i VNM-së hartohet nga personi fizik/juridik i licencuar nga QKL-ja, duke krijuar një grup me specialistë të kualifikuar, sipas fushave përkatëse që trajton raportin i VNM-së, bazuar në kërkesat e shtojcës 2.*

**2. Në dëgjese nuk ka qënë i pranishëm grupi i ekspertëve që kanë hartuar Raportin e VNM –së së Thelluar dhe formulari Tipi II i ardhur nga ARM Lezhë, nuk është i firmosur nga eksperti i mjedisit,** në zbatim të VKM-së nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmartjen mjedisore” të ndryshuar,

*Kreu II, pika 4.1./ d) Zhvilluesi siguron pjesëmarrjen e ekspertit/ekspertëve, që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së, ditën që organizohet dëgjesa publike.*

3. Në sipërfaqen e kërkuar për shfrytëzim nga subjekti “Manfi” sh.p.k , rezulton një tjetër subjekt me Leje Mjedisit Tipi B “Aktive” në sistemin e QKB-së, me të dhënat si më poshtë: “Donaj” Sh.p.k, Leje me Nr.7738 Prot, datë 25.11.2016, (LC-6646), me të njëjtën sipërfaqe dhe me të njëjtat koordinata. Përsa më sipër vendndodhja rezulton zonë e punuar dhe e shfrytëzuar, bazuar në Ligjin nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a) *qëllimi i tij është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim” dhe KREU II, Neni 7, Pika 1. “Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit”, AKM nuk mund të propozojë lëshimin e Deklaratës Mjedisore në të tilla rrethana.*

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ARTA DOLLANI**

**MINISTRI**


**MIRELA KUMBARO FURXHI**

*Konceptoi:*

*Pranoi:*



1. **Anex 1.Harta dhe koordinatat** (sipas Njoftimit Fitues)





Aneksi 2.Harta dhe Koordiatat (sipas lejes se Mjedisit)

